

Pershendetje.

Ne lidhje me kerkimin tuaj ju informojme se:

1. Kërkojmë sa më shpejtë të jete e munduar nga ana Juaj dokumentacionin që ka paraqitur subjekti Geris shpk për inportimin e këtij produkti?!
Duke marre ne konsiderate faktin se, informacioni i kerkuar nga ana Juaj eshte i natyres konfidenciale referuar nenit 20 pika 1 paragrafi i parë i Ligjit nr. 102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor në Republikën e Shqiperise”, i ndryshuar i cili sanksionon:

“Neni 20 Komunikimi i informacioneve dhe mbrojtja e të dhënave

*1. Çdo informacion i marrë nga autoritetet doganore gjatë kryerjes së detyrave të tyre, i cili është i një natyre konfidenciale ose që është marrë në mënyrë konfidenciale, mbulohet nga kushti i sekretit profesional. Me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 2, të nenit 48, ky informacion nuk jepet nga autoritetet kompetente doganore, **pa lejen e shprehur të personit ose autoritetit që e ka dhënë atë.***

Megjithatë ky informacion mund të jepet pa leje, kur autoritetet doganore janë të detyruara ose të autorizuar ta bëjnë këtë në përputhje me dispozitat në fuqi, veçanërisht me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave ose kur ka lidhje me procedimet gjyqësore.

E për kete, Autoriteti Doganor nuk mund t`iu përcjelle informacionin e kerkuar pasi dispozita e sipercituar e ndalon dhenien e ketyre të dhenave tregtare.

Ky informacion mund t`iu vihet në dispozicion vetem pasi pala që disponon të drejten e ketyre të dhenave konfidenciale me karakter tregtar të përcjelle pelqimin/miratimin ose kur keto të dhena/informacione kerkohen nga autoritetet e procedimit gjyqësor.

2. A ka mbrotje doganore subjekti Geris shpk për inportimin e produktit xh 10 insekticid ilaç mizash?
Administrata doganore, si pjese e administrates publike në ushtrimin e funksioneve të saj, mbron në çdo rast interesin publik, si dhe të drejtat dhe interesat kushtetuese e ligjore të operatoreve ekonomik/privat. Në ushtrimin e funksioneve tona, sic e kemi demonstruar ne korespondencen shkresore me ju (dhe jo vetem) kemi trajtuar në mënyrë të paanshme dhe me të njëjtat standarde trajtimi bizneset/subjektet fizike dhe garantojmë që vendimet apo qëndrimet, përsa është e mundur, të jenë të njëjta për çështje administrative të njëjta per të gjitha subjektet me të cilat jemi në marrëdhënie administrative.
3. Në ç`farë faze ndodhet hetimi i thelluar administrativ për 5 punonjësit e doganës Kapshticë për lejimin e produktit H10 insekticid ilaç mizash ?
Bazuar në ligjin nr. 119/2014 PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT, neni 17 pika 2. E drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të mëposhtëm: c) mbarëvajtjen e hetimit administrativ në kuadër të një procedimi disiplinor;

Ju falenderojme për vemendjen e kushtuar!